REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 895/20
Datë/Datum. 19.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	09.11.2019	*19.11.2020*	895/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 06.11.2020, OE :"**SPINP Agency**", ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**895/20,** kundër njoftimit për dhënie të konratës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit "**Mirembajtja e STN-se",** me numër të prokurimit: 204-20-5872-2-3-6 iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues– Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë.**

Data e njoftimit për kontratë 29.09.2020, data e e hapjes së ofertave 08.10.2020, njoftimi për vendimin e AK-22.10.2020, kërkesa për rishqyrtim 26.10.2020, Vendimi mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim: 28.10.2020.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkeljet e pretenduara të:

1. **Të dispozitave të LPP-së.**

> Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për te eliminuar ofertën e **OE: NSH SPINP Agency** nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se tenderi i kësaj kompanie është i papërgjegjshëm në kuptim te dispozitave te LPP-së, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të LPP-së.
Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi l te këtij ligji:

> *l. Të gjitha autoritetet kontraktiiese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondetpublike dhe burimetpublike tëpërdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Nëse i referohemi procesverbalit të hapjes së tenderit do të shohim se çmimi i ofertuar i ofertës së "NSH SPINP Agency" është 3480,00 euro, është çmimi më i ultë në raport me çmimin e OE (Logistic Plus LLC) të propozuar për kontratë

i cili është 5888,00 euro.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se AK: MTI, me vendimin e vet për te shpërblyer me kontratë ofertën e OE i cili për nga çmimi është me i shtrenjtë, se OE: NSH SINP AGENCY ne vlere prej **2408,00** euro, dhe ne kete menyre AK ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 1, të nenin 6 të LPP-së.

Pretendojmë se AK: Ministria e Tregtise dhe Industrise, me vendimin e vet për eliminim të OE: NSH SPINP Agency nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe me marrjen e Vendimit për shpërblim të kontratës për OE: Logistic Plus, me vlerë të kontratës 5888.00 euro i cili për nga çmimi është më i shtrenjtë në vlerë prej 2408,00 euro sesa kompania jonë si OE ofertues me çmim prej 3480,00, ka vepruar në kundërshtim me obligimin ligjor që buron nga neni 6 i LPP-së i cili decidivisht obligon AK-në, që të siguroj që fondet publike dhe burimet tjera publike të përdoren në mënyrën efikase, racionale dhe ekonomike dhe jo të dëmtohet buxheti apo financat publike në këtë shumë prej **2408,00 euro** siq edhe është vepruar.

> Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet që *OE:* Logistic Plus LLC *të shpërblehet me kontratë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender, ne kete rast ne.*

Pabarazia në trajtim si dhe favorizimi i një operatori si dhe diskriminimi i operatoreve Ijerë është bërë nga ana e AK në procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes së OE dhe me rastin e shpërblimit të kontratës. Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurës se vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve që ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente, si dhe eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik Ne si OE, meposhte ne kete kerkese kemi prezentuar faktet dhe deshmite tona reale ne meizyre qe te vertetojme se ne si kompani ofertuese jemi shume profesionale ne fushen e zhvillimit te Softivereve, ivebfaqeve, dizajnit dhe online marketingut, dhejo vetem ne nje lloj/model te softcverit, mirpo ne pergjithesi ne fushen e zhvillimit dhe programimit. Andaj, ne konsiderojme qe komisioni vleresues IAK ka bere shkelje te kesaj pike dhe ka diskriminuai' kompanine tone si ofertuese me cmimin me te lire te ofruar dhe me garancionet tona qe kemi paraqitur si zgjidhje per pikat ejuaja qejane kerkuar tek specifikat teknike, mirpo edhe tek dokumentet e bashkengjitura (si psh CV-te e stafit) dhe deklarata e pershtatshmerise per specifikat teknike te tenderit, ku kemi poashtu siguruar dhe garantuar se ne do tejemi ne teresi ne perputhje me kerkesat specifike dhe dojupergjigjemiper gjitha ato kerkesa siq jane te specifikuara ne dosje dhe gjithsesi se kemi pranuar mundesine e ndeshkimeve nese diqka te tille nuk realizojme dhe keshtu kjo do te duhej te

mjaftonte perveq tjerash qe te siguroheshit mjaftueshem.

> **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit te AK: **Ministria e Tregtise dhe Industrise** ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-së, në Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratatpublike do tëjepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

- *së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;*
- *së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.*

Pretendojmë AK- **Ministria e Tregtise dhe Industrise** ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 56 te LPP-se gjate procedurës se vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ne kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në FDT e dosjes se tenderit.

> ***Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NSH SPINP Agency, si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhojë e kësaj të marr vendim për eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 59 , paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve (edhe pse gjitha dokumentet e kerkuara ne dosjen e tenderit kane qene te bashkengjitura dhe shume te qarta, ne kete rast CV e stafit te kompanise sone ka qene e bashkengjitur dhepoashtu ne te kane qene sakt te spefcifikuara datat e pervojes se punes ne gjitha kompanite dhe e cila i ka permbushur mëse kerkesat e AK te specifikuara ne dosje). Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm

nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i kompanisë NSH SPINP Agency është i pa përgjegjshëm, sepse tenderi i parashtruesit të Kërkesës është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Të ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OE janë të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në FDT të dosjes së tenderit.

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;
b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;
c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

Duke u bazuar në Letrën standarde të tenderuesit të eliminuar të dërguar nga AK : **Ministria e Tregtise dhe Industrise** shohim se AK ka marrë vendim për eliminim nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se:

Dëshmitë e dokumentuara dokumentare mbi plotësimin e kërkesës së përcaktuar në paragrafin III.4 te FDT-se:

- Kërkesat mbi mundësitë teknike apo profesionale,

Citoj pjesë nga arsyetimi i njoftimit:

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	***Kapaciteti teknik dhe professional*** ***Lista e kontratave duhet te jetë me vlerë sc paku 10,000.00 euro, për natvrën e ngjashëm(ne fushën e mirembajtjes se sistemeve apo ekuivalente) të realizuara dhe të përcjelluar me referenca për kontratat e natyres se ngjajshme,gjatë 3 viteve te fundit prej datës se njoftimit për kontratë***	Dëshmia e kërkuar dokamenlar ***OE të dëshmoj listën e kontratave ,lista duhet te jete origjinal e vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhc kopja e referencës për kontratat e njejta, gjatë periudhës së fundit***
	Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 persone si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit.	***Kopjen e diplomes dhe përvoja të dëshmohet me CV***

Arsyetimi i eliminimit nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit është i pa baze dhe i pa qëndrueshëm dhe ne kundërshtim me dëshmitë e dokumentuara ne Listën e stafit te Kompanise sone.
Në liste kemi prezantuar disa persona, e nder te tjera edhe personin te diplomuar ne shkencat kompjuterike dhe me pervojen e kerkuar, ku poashtu kemi bashkengjitur Diplomen qe vereteton qarte dhe sakt qe ka diplomuar ne Shkencat Kompjuterike, dhe
CV-ne e Personit ne ijale, ku deshmone sakt dhe shume qarte pervojen e tij te punes neper kompani te ndryshme dhe qe mbulon periudhen prej me shume se 3 vjeqare, aq sa edhe ju si AK keni kerkuar ne kete dosje tenderi.
Pra, siq mund te shifet me larte ne kerkesat e juaja si AK, thuhet decidivisht dhe shume qarte:
"Pervoja te deshmohet me CV", dhe ne CV e bashkengjitur nga ana jone per stafin tone, mund te vertetoni qe stafi ka pervoje me shume sesa 3 vjeqare, apo mund te themi qe pervoja e tij eshte me shume sesa dyfishi i asaj kerkuar nga ju si AK. Perveq tjerash, pervoja e Stafit ne fjale, mund te vertetohet nga ju tani me edhe me nje reference shtese nga nje punedhenes paraprak i stafit tone ne fjale, por edhe nga ju duke kontaktuar drejtperdrejte personat-pronaret e kompanive ne fjale qe mund ti gjeni dhe shifni ne CV te prezentuara, si punedhenes te tij paraprak.
Pra, bazuar ne kerkesat tuaja te specifikuara tek dosja e tenderit, thujet decidivisht qe Pervoja duhet te deshmohet me CV dhe jo nga momenti i diplomimit.
Mbi te gjitha, vlene te potencohet se kompania jone: SPINP Agency, ka te punesuar mbi 30 persona dhe perveq personit ne fjale, ne kemi edhe personel tjeter te angazhuar me kualifikime shume me te larta sesa keto qe kane qene te kerkuara, mirpo ne kete dosje tenderit eshte kerkuar vetem 1 staf dhe ne kemi prezentuar tre te tille qe te deshmojme se kemi kapacitete te kerkuara nga ju, mirpo deshmi jane edhe punet-kontratat tjera te realizuara te bashkengjitura dhe qe jane sisteme shume me te avansuara dhe ne fakt asnje nga keto nuk mund te realizoheshin poqese nuk do te kishim stafin e kualifikuar dhe profesional.

Qfar na ka bërë edhe më shumë te kemi dyshime neve si OE është fakti që sot ne ora 10:13 pranuam përmes platformës së e-prokurimit vendimin mbi pezullim dhe vetëm pas 1 minuti, ne ora 10:14, menjhere pranuam refuzimin e kerkeses sone per rishqyrtim te tenderit, pra zyrtaret e AK ne fjale na kane lene te kuptojme qe as qe jane marr me kerkesen tone, respektibisht me gjetjet dhe faktet ton ate prezantuara, mirpo vetem kane refuzuar kerkesen tone duke mos u bazuar ne fakte dhe ne deshmi ton ate prezantuara dhe ne kete forme sigurisht se na demtojne neve si OE serioz dhe te pergjegjshem dhe po ashtu demtojne fondet e buxhetit te shtetit, duke shperblyer me kontrate OE tjeter me cmim shume me te larte.

Andaj, pretendojmë se AK: Minstria e tregtise dhe Industrise, gjatë procedurës së vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderit nuk i ka vërtetuar drejtë dëshmitë e dokumentuara mbi plotësimin e kërkesës se AK-së, te përcaktuar ne paragrafi III .4 te FDT-se *sepse Kompamajone NSH SPINPAgency ka ofruar dëshmi të dokumentuara dokumentare mbi plotësimin e këtyre kërkesave duke ofruar*

dëshmi se i plotëson kërkesën e AK-së te kërkuara ne paragra fm III.4 *te FDT-se.*

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

> ***Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NSH SPINP Agency si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhojë e kësaj të marr vendim për eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 72, paragrafin 1, 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.
LPP obligon Autoritetin kontraktues qe ne rastet kur OE nuk ofron dokumente specifike AK duhet te ftoj operatoret ekonomik për te plotësuar apo qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenin 65 -71 te LPP-se.

Citoj dispozitat e nenit 72 te LPP-së;

l. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket tëjetëjo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhui' brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen nëpërputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund tëftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëmpër dokumentet eJczistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Duke u bazuar në Letrën standarde të tenderuesit të eliminuar të dërguar nga AK: MTI, si dhe obligimin e përcaktuar në bazë të nenit 72 të LPP-se, për të ftuar OE për të plotësuar apo sqaruar dokumentet të cilat ekzistenca e tyre është fiksuar , pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 72 të LPP-së.

2. Shkeljet e pretenduara të;

II. Dispozitave të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

> ***Neni 39, Sqarimi i tenderëve***

Pretendojmë se **AK: MTI** ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 39, te Rregullave dhe UOPP, duke anashkaluar mundësinë e kërkesës për sqarim te tenderit në rast se OE nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshme mbi plotësimin e kërkesave te përcaktuara ne baze te nenit 65-71 te LPP-se.
Sipas nenit 39 të Rregullave dhe UOPP, Autoriteti Kontraktues duhet të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dështmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE.

- Citoj dispozitat e nenit 39 te Rregullave dhe UOPP:
^g.^Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomikpër tëplotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura nëpajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dështmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE"

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura pretendojmë se AK, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 39 të Rregullave dhe UOPP.

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga organi kompetent i AK: **MTI,** që pas shqyrtimit te kësaj kërkese të:

> *Të aprovoj Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit si të bazuar,*
Të anuloj, Vendimin e AKpër shpërblim te kontratës Dhe
*Njofiimin për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit për tenderin e lartshënuar **te OE "NSH SPINP Agency"***
> *Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjes së tenderit dhe LPP si dhe Rregullat dhe UOPP.*

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.

Dëmet Materiale :
Deri më tani nuk kemi pasur dëme materiale.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	**Përshtatshmëria profesionale** **Një deklaratë e nënshkruar nga autoriteti i përshtatshëm publik në vendin tuaj të**	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* **Kopja e Certifikates se biznesit**

	themelimit të regjistrimit tuaj në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës, duhet të dorëzohet, së bashku me përshkrimin e veprimtarive primare dhe sekondare të kompanisë ku edhe përfshihen natyra e ngjashme Kopje e certifikatës së biznesit	
	Certifikatën e Numrit Fiskal.	**Certifikatën e Numrit Fiskal-Kopje**
III.3 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
	Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dështmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tri viteve te fundit prej datës se njoftimit per kontrate ka qenë prej jo më pak se 10,000.00 Euro.	**Te dështmohet nga Banka dhe dështmimi mund të ofrohet edhe përmes institucioneve tjera te përcaktuar me LPP**
III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	**Kapaciteti teknik dhe professional**	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
	Lista e kontratave duhet te jetë me vlerë se paku 10,000.00 euro, për natyrën e ngjashëm(ne fushën e mirembajtjes se sistemeve apo ekuivalente) të realizuara dhe të përcjelluar me referenca për kontratat e natyres se ngjajshme,gjatë 3 viteve te fundit prej datës se njoftimit për kontratë	**OE të dështmoj listën e kontratave ,lista duhet te jete origjinal e vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhe kopja e referencës për kontratat e njejta, gjatë periudhës së fundit**
	Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 persone si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit.	**Kopjen e diplomes dhe përvoja të dështmohet me CV**

RAPORTI i KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PER RISHQYRTIM)

VENDIM

MBIREFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZË

I. Refuzohet kërkesa e propozuar për shqyrtim si e pabazë, e Operatorët Ekonomik N.SH. " Spinp Agency "-Prishtinë-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e STN-së"-MTI204-20-587^028-2-3-6, të shpallur nga Autoriteti Kontraktues - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

II. Vërtetohet, vendimi i Autoritetit Kontraktues - MTI, njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e STN-së"-MTI204-20-587^028-2-3-6,

III. Autorizohet, Autoriteti Kontraktues - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që të respektoj vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, duhet të pres së paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marr një vendim, në përputhje me nenin 8.1.1 pika (ii) e Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja.

IV. Obligohet, Autoriteti Kontraktues - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që refuzimin e

kërkesës për rishqyrtim të ja komunikoj parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

V. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i detyrueshëm për autoritetin kontraktuese dhe duhet të zbatohet menjëherë.

VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Si Autoritet Kontraktues Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me datën 29.09.2020 ka tenderuar në procedurë e kuotim çmimi në vlerë të vogël për tenderin: "Mirëmbajtja e STN-së"-MTI204-20-5872/028-2-3-6, sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237.

Në procesin e hapjes me datë 08.10.2020 kemi pranuar dy (2) oferta nga operator ekonomik të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Komisioni i vlerësimit pasi ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ka ardhur në përfundim se operatori ankues N.SH. "Spinp Agency". kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshëm, ku më datë 22.10.2020 janë njoftuar me njoftimin për tenderuesit e eleminuar dhe me të njëjtën datë është ngritur vendimi mbi njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit përmes platformës së E-prokurimit të KRPP-së.

Me datë 25.10.2020 kemi pranuar ankesë/kërkesën për rishqyrtim të vendimit të AK-MTI, nga OE N.SH. "Spinp Agency"-me pretendimin se është shkelur Neni 6 Ekonomiciteti dhe EfikasitetiNeni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe sipas UOPP neni 39

Pas pezullimit të këtij aktiviteti me datë 28.10.2020, sipas dispozitave ligjore të LPP-së të nenit 108/A, dhe në përputhje nenin nenin 8.1.1 pika (ii) të regullave për parashtrimin e ankesave të nxjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pikat e ankesës duke konstatuar se :

Pika e ankesës lidhur me Nenet lart shënuar, nuk qëndrojnë pasi OE as që ka dhënë argumente për pretendimin e shkelur ligjor, në këtë rast AK-MTI ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave në mënyrë të argumentuar, të drejtë dhe korrekte duke trajtuar të gjithë OE pjesëmarrës në mënyrë të barabartë duke vlerësuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në plotësimin e secilës kërkesë dhe kriter në dosjes, prandaj konstatojmë edhe një herë se oferta OE N.SH. " Spinp Agency "-Prishtinë është e papërgjëshëme duke mos plotësuar kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit sipas kriterit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 persone si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te prof esionit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kopjen e diplomës dhe përvoja të dëshmohet me CV.

Në ofertën tuaj nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në 69 të LPP, që nuk i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratë, ku ju në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar përmes platformës së E-Prokurimit nuk keni ofruar inxhinierin e shkencave kompjuterike për përvojë 3 vjeçare pasi inxhinierin e ofruar është diplomuar me date 22.11.2018, ne këtë rast inxhinier nuk munde te quhet pa diplum dhe përvoja e punës është kërkuar 3 vite ne fushë veprimit te profesionit te inxhnirit ndërsa per sqarime shtese nuk ka pasur nevoje pasi ne listën e stafit te ofruar keni ofruar vetëm personi/inxhinieri i cili ka diplomuar me 22.11.2018 qe nuk plotëson kërkesat ligjore sipas LPP dhe UOPP

Siç u tha me lartë konsiderojmë se nuk qëndrojnë asnjë nga pikat e ankesës të dorëzuar nga OE N.SH. "Spinp Agency"- Prishtinë, dhe se procesi i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, UOPP-së dhe akteve tjera nërdigjore dhe në respektim të plotë të kritereve dhe kërkesave të specifikuara në dosje të tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SPINP Agency"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.895/20 është arsyea e eliminimit të OE ankues, ku sipas arsyetimit të AK-së OE akues nuk ka plotësuar kërkesën :

"Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 persone si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë **diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike**, se paku përvojë pune **3 vite ne fushë veprimit te profesionit."**

Ndër të tjera në arsyetimi i AK-së për eliminim është thtoë :

"*...ju në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar përmes platformës së E-Prokurimit nuk keni ofruar* ***inxhinierin e shkencave kompjuterike për përvojë 3 vjeçare*** *pasi* ***inxhinierin e ofruar është diplomuar me date 22.11.2018****, ne këtë rast* ***inxhinier nuk munde te quhet pa diplom*** *dhe përvoja e punës është kërkuar 3 vite ne fushë veprimit te profesionit te inxhnirit ndërsa per sqarime shtese nuk ka pasur nevoje pasi ne listën e stafit te ofruar keni ofruar vetëm personi/inxhinieri i cili ka diplomuar me 22.11.2018 qe nuk plotëson kërkesat ligjore sipas LPP dhe UOPP...*"

Fillimisht sqarojmë në kërkesa të AK-së nuk është kërkuar Inxhinier, e po ashtu çka është me rëndësi në

rastin konkret nuk është kërkuar shprehimisht që përvoja 3 vjeqare duhet të jetë pas diplomimit universitar, kërkesa decidive ka qenë:

"...diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite **ne fushë veprimit te profesionit".**

Nga CV e ofruar prej OE ankues, shihet se personi në fjalë ka përvojë si "Softëare Developer" që nga viti 2014.

CV

Drin Percuku Vushtrri

Republika e Kosovës

+383 49 490 100

Drin.percuku@spinpagency.com

EXPERIENCE

Spinp Agency
2019 - Present
Backend Developer

- **Responsible for the architeture, development and implementation of a ëide variety of Ëeb-based products.**
- **Responsible for developing costumized CMS (CMS Canvas) using PHP, JavaScript, relational databases, broxvser Extensions.**
- **Responsible for training the staff and clients in using the products (like: CMS, Databases, E-commerce, Email modules,etc.)**
- **Developing strategies to implement solutions**
- **Identifying resources and using them efficiently**
- **Analyzing IT needs vvithin organizations and designing business strategies**
- **Conducting research and market analysis**
- **Giving objective advice on the use and benefits of IT**

Dina Tech
08/2017 -09/2019
Softëare Developer

- **Supervise preparation and regular updating of class schedules and changes**
- **Responsible for the development and implementation of Ëeb-based products using PHP, JavaScript, relational databases, brovvser Extensions.**
- **Perform marketing strategies to promote classes and programs**
- **Prepare detailed financial reports totaling thousands of dollars**
- **Integration of academic planning and class scheduling**

Illv Soft
2014-2017
Softëare Developer - Backend Developer

- **Developing Ëeb-based products using PHP. JavaScript, MySql, Codeigniter, Laravel, brovvser Extensions. etc.**

Freelancer Softëare Developer
2013- on going
Full Stack Developer
Developing and maintaining different kind of ëeb projects. using mainly PHP, MySQL. Javasript. as a freelancer/indepedentlv.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se OE ankues ka dorëzuar ofruar dëshmitë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

MENDIMI i EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MTI
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – SPINP Agency